

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Aktivistja: Do të vijojmë bllokimin e institucioneve dhe Kuvendit. Nuk na përfaqësojnë
ADRESA	https://piranjat.al/aktualitet/dhuna-policore-protestuesit-para-lajmerojne-pershkallezim-do-bllokojme-i104105
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	edited

KOHË


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 18:34:57 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 18:31:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	346d4efc016af38f35cc93ac7aecb3b00c99e80255bd5ee31c15f8d1a818d65e
TEKSTI	22d7c364eba033b890a340f261ceefd1281d0db1b3b363cae8838a91628a91d3
PAMJA	d70ae084f6acc193cff838d0f9db4ca776955da2a198fc960a9c97a647a8af66

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	545544cb41d184e3f223c1dca78df595c9b326edd91abcce3f2ce356e3012ea7
E MËPARSHMJA	af790b274fdb47183b1cd139df87dbb2d6abd5109c5847aec876102dc70c082
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon një rën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/545544cb41d184e3f223c1dca78df595c9b326edd91abcce3f2ce356e3012ea7>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash:

[dhe kërcënon](#)

duke tu drejtuar me fjalët:

[kush janë tre](#)

me burg për rolin e tij si kultivues në një fermë

[Veriut shkaktojnë një](#)

Cardiff, nënshkruan

[lirohet, është](#)

prag të seancës që pritet të

[Edi Ramës](#)

protestuesit më...

AKTUALITET

Aktivistja: Do të vijojmë bllokimin e institucioneve dhe Kuvendit. Nuk na përfaqësojnë

Piranjat Përditësimi i fundit 14 Shtator 2026, 20:31



Dhuna e pretenduar policore gjatë protestës së 107-të kundër qeverisë së Edi Ramës ka sjellë reagimin e protestuesve, të cilët e kanë cilësuar ndërhyrjen e efektivëve si tejkalim të kompetencave.

Protestuesit deklarojnë se pavarësisht presionit dhe forcës së përdorur nga policia, protesta do të vijojë dhe se do të vazhdojnë edhe bllokimin e institucioneve dhe të Kuvendit.

Aktivistja Luçiana Kokaj tha se protesta është shndërruar në një qëndresë të vazhdueshme qytetare dhe politike, duke theksuar se qytetarët vijojnë të dalin në shesh pavarësisht përpjekjeve për ta shuar atë.

"106 ditë përballë pushtetit që mendojnë se do të shuajnë protestën, por ne jemi ende këtu. Është qëndresë e pastër qytetare dhe politike, jo protestë e çastit. Sot protestuesit u përballën me dhunë e represion policor, si në Zvërnec. Kjo dhunë nuk mund të injorohet, duhet dënuar me forcë të lartë, jo vetëm për tejkalim kompetencash, por po përdoret për të frikësuar qytetarët", u shpreh Kokaj.

Ajo theksoi se qëndrimi i protestuesve mbetet i pandryshuar dhe se forca e tyre, sipas saj, qëndron të bashkimi qytetar.

"Qëndrimi ynë është i qartë, forca jonë është bashkimi i qytetarëve. Jemi sërish në shesh sepse mendojmë se kjo protestë paqësore tregon si shqiptarët shohin veten", deklaroi aktivistja.

Kokaj tha gjithashtu se ndryshimi, sipas saj, nuk mund të vijë përmes dhunës apo përshkallëzimit, por përmes refuzimit të asaj që qytetarët e konsiderojnë të papranueshme.

"Ndryshimi nuk vjen as nga hedhja, as nëpërmjet dhunës, as në përshkallëzim zemërak, por vjen nga njerëz që vendosin të mos pranojnë të papranueshmen", tha ajo.

Në fund, aktivistja paralajmëroi se protestuesit do të vijojnë aksionet e tyre dhe bllokimin e institucioneve.

"Do të vijojmë bllokimin e institucioneve dhe Kuvendit. Nuk na përfaqësojnë. Zhvendosja e vëmendjes nga protesta do të ishte lirim për Ramën", u shpreh Luçiana Kokaj.

Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 14 Shtator20:22

["Nuk kanë forca të menaxhojnë situatën në bulevard"/ Protestuesi: Frontin nuk do e lëshojmë, jemi afër fitores](#)

Një qytetar pjesëmarrës në tubimin përballë godinës së Kryeministrit në ditën e sotme, ka marrë fja...

AKTUALITET 14 Shtator20:12

[EMRAT/ Fermë droge prej 4.5 milionë paund në klubin e natës, kush janë tre shqiptarët që u hodhën nga çatia e ndërtesës. Ja kush i 'tradhtoi'](#)

Një shtetas shqiptar është dënuar me burg për rolin e tij si kultivues në një fermë kanabisi me vlerë 4.5 milion&eu...

AKTUALITET 14 Shtator20:04

[Polici goditi me ërushat protestuesin. Krenar Ahmeti: Siellie brutale, u shkel cdo lloi norme](#)

Ish efektiv i Policisë, Krenar Ahmeti komentoi dhunën e ushtruar nga një polic ndaj një qytetari sot gjatë protestës së zh...

AKTUALITET 14 Shtator19:48

"Revolta kur ndizet nuk ndalet", Tepelena: Balluku me vilë sekrete, pensionistët mezi blejnë ilaçet

Protesta kundër qeverisë ka vijuar për të 107-ën ditë radhazi para Kryeministritë, ku qytetarët janë mbledhur s&eum...

AKTUALITET 14 Shtator19:40

Shkrirja e Divjakës me Lushnjën, bashkia mbledh argumentet kundër: Relacioni shkon në Kuvend

Komisioni i ngarkuar nga Këshilli Bashkiak i Divjakës për përgatitjen e relacionit kundër shkrirjes së Bashkisë Divjakë,...

AKTUALITET 14 Shtator19:39

"AMG Food" e skandalit të Salmonelës, pronare e kontejnerit me mish pule ku u gjetën 41 kg kokainë

Detaje të reja kanë dalë në dritë nga operacioni i zhvilluar ditën e sotme në Portin e Durrësit, ku Policia sekuestroi 4...

AKTUALITET 14 Shtator19:34

Akuzohet se abuz*i me mbesën, 51-vjeçari shqiptar lihet në burg! Hetimet zbulojnë fakte të tmerrshme edhe me të bijën

Me vendim unanim të gjyqtarit hetues dhe prokurorit, 51-vjeçari me origjinë shqiptare u la në paraburgim për abuzim seksual ndaj mbes...

AKTUALITET 14 Shtator19:15

Nuk ndalet revolta kundër Ramës, nis marshimi qytetar drejt Kryeministritë

Qytetarët kanë dalë sërish në rrugët e Tiranës këtë të hënë, duke shënuar ditën e 107-t&eum...

AKTUALITET 14 Shtator18:49

Hall me bord e hall pa bord! Nafta drejt 230 lekë për litër, qeveria rri duarkryq

Nafta kërcen në 229 lekë, benzina në 219 lekë për litër, një ditë pas deklaratës së qeverisë për...

AKTUALITET 14 Shtator18:26

U dëbua nga Italia, i riu shqiptar kthehet me emër tjetër. Arrestohet për trafik kokaine

Supozohej të ishte një kontroll rutinë trafiku nga Karabinierët e Njësisë Operative dhe Radiomobile të Viadanës, por kur...

ME TE VIZITUARAT

BOTA 13 Shtator

"Kaos" në fluturimin Australi-Katar/ Dy burra p...

Një incident është regjistruar në bordin e një fluturimi nga Melbourne drejt Dohas, ku dy pasagjerë meshkuj u bënë agre...

AKTUALITET 13 Shtator

Të shtëna me armë pranë një lokali në Greqi, dy...

Shqiptari Alket Rizai, ish-bashkëpunëtor i të shumëkërkuarit grek Vasilis Paleokostas dhe i njohur për arratisjen dy herë m...

POLITIKE 14 Shtator

FOTO- 'Mos u kthe më në Shqipëri'/ Edi Rama sul...

Edi Rama ka sulmuar me thonj dhe ka kërcënuar një emigrant shqiptar në Napoli duke iu drejtuar me fjalët: Të zhduk. Gazetari &C...


INVESTIGIME 31 Maj14:01

Gratteri për Piranijat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik


Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video





Çdo të premte | ? 20:45 | Syri TV





Çdo të premte | ? 20:45 | ??? Syri TV



Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave



DIDANIAT SHOW - SEZONI 6 EPISODI 16



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.